



UNMIK/PR/1635

E martë, 30 janar 2007

## **PSSP informoi Këshillin e Evropës për Kosovën**

PRISHTINË – Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së në Kosovë (PSSP), Joachim Rucker, sot vizitoi Këshillin e Evropës ku i informoi zëvendësit e Komitetit të Ministrave dhe mbajti takime të ndara me sekretarin e përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Terry Davis, si dhe me zyrtarë të tjerë të lartë. Ndër çështjet e diskutuara ishin situata në Kosovë në prag të procesit të statusit, kthimi i pakicave, mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore, gjendja e përgjithshme e të drejtave të njeriut në Kosovë, përfshirë këtu emërimin e ombudspersonit, panelin këshillëdhënës për të drejta të njeriut dhe regjistrimin testues në Kosovë.

Z. Rucker ndau perspektivën e tij nga pikëpamja e UNMIK-ut si prani e OKB-së në terren në Kosovë. Ai theksoi rëndësinë e zgjidhjes me kohë të statusit që do ta ndihmojë në masë të madhe përmirësimin e stabilitetit në rajon. “Statusi do të jetë fillim i ri për Kosovën,” tha ai, “Statusi vazhdon të jetë çështje dominuese për të gjithë që interesohen për Kosovën dhe rajonin e Ballkanit perëndimor.”

PSSP falënderoi Këshillin e Evropës për kontributin e rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Ai tha se në Kosovë janë themeluar mekanizmat dhe institucionet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si ombudspersoni dhe paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut për të cilin tre personat e nevojshëm u emëruan kohët e fundit.

Z. Rucker gjithashtu i informoi zëvendësit për punën e komisionit për zbatimin e rindërtimit (KZR), organ i kryesuar nga Këshilli i Evropës, që mbikëqyr zbatimin e projekteve të rindërtimit dhe rehabilitimit të objekteve fetare ortodokse serbe që u dëmtuan gjatë trazirave të marsit 2004. “Ajo që e bën KZR-in unik është se ai është një prej fushave të pakta në të cilat IPVQ-ja, autoritetet e Beogradit dhe përfaqësuesit e kishës ortodokse serbe po punojnë bashkë drejt një qëllimi të përbashkët,” tha ai. PSSP vuri në pah nevojën për angazhim të vazhdueshëm të udhëheqësve politikë të Kosovës për mbështetjen e respektit për trashëgiminë kulturore, që mund të ndihmojë shumë në ndërtimin e besimit ndërmjet bashkësive, si dhe në shtyrjen përpara të kontakteve të ardhshme me Beogradin, pasi kjo është “një prej pak fushave ku ka dialog të sigurtë në nivel të ministrave ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit”.